



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues
Dr. sc. Sabri Sadiku

Nr. Prot. 838
Dt 29.05.2018

Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 15.5.2018, mori:

VENDIM

- I. Prof. ass. dr. Agron Beka, u. d. dekan në Fakultetin Juridik, i aprovohet kërkesa për mbështetje financiare për botimin e revistës shkencore të Fakultetit Juridik "Ius Publicum, Ius Privatum".
- II. Shuma e mjeteve të lejuara për këtë destinim është në lartësi deri në 1000 €:
 - 800 euro për shtypje të revistës;
 - 200 euro për organizimin e ceremonisë për promovimin e revistës.
- III. Shpenzimi i mjeteve për botimin e kësaj reviste do të bëhet në bazë të procedurave të prokurimit që do t'i zhvilloj UMIB.

Arsyetim

Këshilli Drejtues pasi shqyrtoi kërkesën e prof. ass. dr. Agron Beka, u. d. dekan në Fakultetin Juridik, për mbështetje financiare për botimin e revistës shkencore të Fakultetit Juridik "Ius Publicum, Ius Privatum", e konsideroi të arsyeshme kërkesën për shkak se kjo iniciativë e Fakultetit Juridik është një mundësi unike që stafi akademik të aktivizohen në kërkime shkencore si pjesë e aktiviteteve akademike në fushën e së drejtës, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendurit;
3. Shërbimit financiar të UMIB-it;
4. Zyrës së prokurimit të UMIB-it



Kryesuesi Këshillit Drejtues

Dr. sc. Sabri Sadiku